

V E N D I M
Nr. 470, datë 6.10.1999

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT QEVERTAR TË LUFTËS
KUNDËR KORRUPSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri dhe Ministër kryetar i Koordinimit Qeveritar
- Ministri i Drejtësisëanëtar
- Ministri i Rendit Publikanëtar
- Ministri i Financaveanëtar
- Ministri i Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendinanëtar
- Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimitanëtar
- Ministri i Informacionitanëtar
- Drejtori i Departamentit të Administratës Publikeanëtar
- Drejtori i Agjencisë së Prokurimitanëtar

Në mbledhjet e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit ftohen të marrin pjesë edhe Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

1. Komisioni Qeveritar i Luftës kundër Korrupsionit ka për detyrë:

- të udhëheqë dhe të mbikqyrë procesin e rishikimit dhe zbatimit të planit antikorrupsion;
- të miratojë strukturën dhe përbërjen e grupeve të ekspertëve për rishikimin e planit antikorrupsion;

të përcaktojë përbërjen dhe strukturën e grupit monitorues antikorrupsion dhe t’ja paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave;

të miratojë planin antikorrupsion, të rishikuar dhe t’ia paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko